




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

Nr. \_\_\_\_\_

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 11 nënparagrafi 1.5 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.34/18 nëntor 2022) nenit 10 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës nr.7/01 mars 2019), Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi (Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës nr.17/10 qershor 2016), ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 06/L-066 dhe Ligjin 08/L-176, nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës nr.21/13 qershor 2013), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2024 për Trajnimin dhe Dhënien e Provimit për Menaxher të Transportit Rrugor të Udhëtarëve dhe Mallrave dhe Kualifikimin Profesional për Shoferë Profesionalistë, nxjerr:

## V E N D I M

Për caktimin e tarifës për trajnime dhe paraqitjen e provimeve

I. Për të marr pjesë në trajnimin bazik dhe periodik për CPC dhe trajnimin periodik për CKP si dhe për paraqitjen e provimit për CPC dhe CKP, kandidati duhet të paguaj shumat e përcaktuara në tabelën 1 dhe 2.

Tabela 1. Trajnimet dhe provimet për CPC

	Tarifa
Trajnimi bazik për kompetencën profesionale (CPC) për menaxherin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave	35 Euro
Provimi profesional dhe riprovimi për kompetencën profesionale (CPC) për menaxherin e transportit rrugor të mallrave	10 Euro
Provimi profesional dhe riprovimi për kompetencën profesionale (CPC) për menaxherin e transportit rrugor të udhëtarëve	10 Euro
Trajnimi periodik për kompetencën profesionale (CPC) menaxherin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave	20 Euro

Tabela 2. Provimet dhe trajnimi për CKP

	Tarifa
Provimi profesional dhe riprovimi profesional për kualifikimin fillestar të CKP-së, nga pjesa teorike dhe praktike për shofer të transportit rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve	10Euro
Provimi profesional dhe riprovimi profesional për kualifikimin fillestar të CKP-së, nga pjesa teorike dhe praktike për shofer të transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave	10 Euro
Trajnimi periodik, për kualifikimin profesional për CKP për transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve	15 Euro
Trajnimi periodik, për kualifikimin profesional për CKP për shofer të transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave	15 Euro
Provimi profesional dhe riprovimi për kualifikim profesional për CKP-periodike për shofer të transportit rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve	10 Euro
Provimi profesional dhe riprovimi për kualifikim profesional për CKP-periodike për shofer të transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave	10Euro

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**

- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit Transportit Përgjithshëm;
- Departamentit Patentë Shoferit dhe Automjeteve;
- Arkivit MMPHI- së.

Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe  
Infrastrukturës

